

## PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** *“Shtrese tapeti rruget e vitit 2024”*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **45233100-0**

#### **PËRCAKTIMI DHE ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :**

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet/Relacioni Teknik/preventive dhe grafiku per proceduren respektive jane hartuar nga grupi qe ka hartuar edhe projekt/ preventivin perkates te zbatimit specialiste te fushës nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit. *Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë kontrolluar dhe janë gjetur në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.*Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve/Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike,argumentimi i numrit te punonjesve dhe numrit te mjeteve dhe makinerive për këtë objekt prokurimi është bërë nga specialisti i fushës, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

#### **VLERA E FONDIT LIMIT:**

**11.764.505** (njëmbëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjet e katër mijë e pesëqind e pesë) lekë pa tvsh

Fondi Limit i perlloritur per kete procedure eshte hartuar sipas manualit teknik per vitin 2024, në zbatim të urdhërit të brendshëm të titullarit të AK “Mbi Përgatitjen e kriterëve Teknike dhe Përlloraritjen e Vlerës Limit të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve, bazuar ne dokumentat sipas buxhetit te bashkise te vitit 20254 të miratuara nga Këshilli Bashkiak si dhe dokumentave lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Maliq**\_ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **SPECIFIKIMI TEKNIKE**

Shtrese asfaltobetoni 4 cm

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m2 shtrese asfaltobetoni me trashesi 4 cm, pas ngjeshjes me rul 12 ton , dhe siguron pjerresite sipas profilave gjatesor dhe terthor, ne cmim futet teresia e shpenzimeve blerjen e asfaltit , transportin sipas kushteve teknike shperndarjen e tij ne kasoneten e rruges dhe ngjeshjen e tij me rul 12 ton sipas kushteve teknike . Shtrimi I asfaltit te behet me makine shtrimi dhe ne nje kohe te pershtateshme .Asfaltobetoni te plotesoje te gjitha kushtet teknike , shoqeruar me certificate cilesie .Ne siperfaqe te mos kete gropeza per mbajtjen e ujit. Ne cmim futet dhe testet e bera per standartin e asfaltit.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

#### **2.1 Per kapacitetin ligjor /profesional te operatoreve ekonomike:**

Sipas kriterëve të përgjithshme të Pranim / Kualifikimit.

*Operatori ekonomik duhet të ushtrojë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi, të paraqitur në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe vërtetuar nëpërmjet ekstraktit të regjistrit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit.*

#### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për ”Procedurës Tatimore ”neni 64 Deklarata Tatimore.*

**2.2.2** Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet 2021,2022,2023 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit

të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

**Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.**

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

Kriteret e kërkuara në pikën 2.2.1 dhe 2.2.2. janë vendosur me qëllim që të vërtëtohet se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë kapacitetet e nevojshme financiare për përmbushjen e kontratës.

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetet për vitin 2024 sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

\* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

### **2.3.1 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se ka :**

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së kontratës që prokurohet ,dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**Ose**

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë se

bashku gjate pese viteve te fundit te jete jo me e vogel se fondi limit i kontrates qe prokurohet.

### **Plotësimi i njërës prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

*\*Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat.40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.*

### **2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës: Operatori ekonomik duhet të dorëzojë:**

- a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

1. NP 4 - A (Punime rrugë, autostrada)

*\*Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

(Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te dorezoje licencat profesionale sipas zerave te preventivit qe ne baze te marreveshjes se bashkepunimit merr persiper te realizoje).

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Vendimit Nr. 943, datë*

28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, "për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" (shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategori a e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikasi mit i kërkuar për kategori në respektiv e	Vlera e punimeve (pa tvsh) që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP 4	<i>Punime rrugë, autostrada</i>		A	

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një Deklarate ne formularin përmbledhes te vetëklarimit (nga Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë te perfshirë në licensën e shoqërisë. Drejtuesi teknik duhet te jete :

- Inxhinier Ndertimi (1)

**“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :**

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë

*Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe natyrën e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas formularit të vetdeklarimit se ka një punonjës i cili është i pajisur me Çertifikatë trajnimi për *”Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”*, e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj *Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht quhet i plotësuar edhe kur vetëm 1 operator ekonomik paraqit dokumentat per punonjesin* të pajisur me certifikatë trajnimi për *”Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”*.

**“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.**

**Argumentimi:** Për kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.3. Njësia e Prokurimit është bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, *”Për Prokurimin Publik”* datë 23.12.2020, pika 4 si dhe në VKM nr 285 datë 19.05.2021 *“për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”* neni 39 pika 6 c. Duke marrë parasysh natyrën e punimeve është kërkuar që drejtuesi teknik të jetë inxhinier ndertimi.

**2.3.5** Shoqëria duhet të paraqesë Çertifikatë ISO të vlefshme:

1. ISO 9001- 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë).
2. ISO 14001-2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit).
3. ISO 45001-2018 (Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)

*Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH ose standardeve shqiptare mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatë ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

*Për kriteret e përcaktuara në Kapacitetin teknik, Njësia e prokurimit ka zbatuar VKM Nr.285 date 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 44 ”Kërkesat e cilësisë” , si dhe bazuar në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr.8197 prot. datë 03.09.2018 ,për “Hartimin e Kriereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra,punë,shërbime. Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të jetë i certifikuar me certifikatat Iso .*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë

mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit. ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

**2.3.6** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të deklaroje ne formularin e vetdeklarimit se ka të punësuar, minimalisht 6 punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- **Manovrator** (2)

*“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :*

**Kur mjetet janë ne pronesi**

1. kontrata e punës (e vlefshme)
2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor

**Kur mjetet janë me qera**

*Deklarate nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqese kontrate pune me manovratorin( i cili duhet të kete Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rruge ) deri në perfundimin e afateve te kontrates.*

- **Punetore te thjeshte** (2)

*“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :*

1. kontrata e punës e vlefshme;

- **punonjës shofer kamioni** (2)

*“Perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit autoriteti kontraktor I kerkon ofertuesit I kualifikuar I pari ,dorezimin e dokumentave provuese si dhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuar ne menyre elektronike si me poshte:*

1. kontrata e punës (e vlefshme);
2. leje drejtimi kategoria C

- **punonjës shofer kamioni**

Jane kerkuar 2 punonjes shofer kamioni per mjetin vetshkarkues per transportimin e materialeve te ndryshme.

- **Punetore te thjeshte**

Jane kerkuar 2 punetore te thjeshte per te kryer punimet sipas preventivit dhe grafikut te percaktuar.

- **Manovrator**

jane kerkuar 2 manovrator per drejtimin e asfaltoshtruseses dhe rulit..

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorë ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Shënimi-argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

**2.3.5** Operatori Ekonomik duhet te deklaroje ne formularin e vetdeklarimit se ka një punësim mesatar i të paktën 6 (gjashte) punonjësish për muajin e fundit.

**“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :**

- a. **Vërtetim** të lëshuar dhe konfirmuar (me firme dhe vule) nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit.

**Dhe**

- b. **Listpagesat** e konfirmuar (me firme dhe vule) nga Administrata Tatimore të punonjësve sipas formatit që kërket nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

*Kriteret e percaktuara ne piken 2.3.5. Eshtë kerkuar që operatori ekonomik të ketë një staf prej 6 punonjësish për të realizuar punimet ,nga zberthimi i preventivit të punimeve me manualin e miratuar sipas VKM Nr 216 date 13.04.2023.*

*Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike*



(të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 6 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të çdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda afatit, Njëpërmet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Zberthimi

#### **OBJEKTI : SHITRESE TAPETI RRUGET E VITIT 2024**

<b>N r</b>	<b>Nr.An</b>	<b>EMERTIMI I PUNIMEVE</b>	<b>Njesi a</b>	<b>Sasi a</b>	<b>OP /NJ</b>	<b>OP GJITH</b>
1		<b>SISTEMIM ASFALTIM FSHATI LIBONIK (LAGJIA E RE) L=325 ml</b>				
I		PUNIME NE RRUGE				
1	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni t = 4cm	m2	1300	0.09 5	124
2		<b>SISTEMIM ASFALTIM RRUGA KISHNIK VRESHTAS 2024 L=200 ml</b>				
		PUNIME NE RRUGE				
1	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni t = 4cm	m2	1200	0.09 5	114
3		<b>SISTEMIM ASFALTIM RRUGA VASHTEMI 2024 L=200 ml</b>				
		PUNIME NE RRUGE				
1	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni t = 4cm	m2	1100	0.09 5	105
4		<b>SISTEMIM ASFALTIM RRUGA BREGAS L= 330 ml</b>				
		PUNIME SHITRESA NE RRUGE				
1	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni t = 4cm	m2	1650	0.09 5	157
5		<b>SISTEMIM ASFALTIM FSHATI KOLANEC 2024 L=450 ml</b>				
		PUNIME NE RRUGE				
1	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni t = 4cm	m2	1200	0.09 5	114

		SHUMA 5				
6		<b>SISTEMIM ASFALTIM RRUGE TE BRENDSHME POCESTE L=160 ml</b>				
		PUNIME SHTRESA NE RRUGE				
1	3.226/1	<b>Shtrese asfaltobetoni t = 4cm</b>	m2	800	0.09 5	76
7		<b>SISTEMIM ASFALTIM SHESHE XHAMIA MALIQ 2024</b>				
		PUNIME SHTRESA NE RRUGE				
1	3.226/1	<b>Shtrese asfaltobetoni t = 4cm</b>	m2	1040	0.09 5	99

- Nga zberthimi i preventivit oret e punes per cdo ze punimi rezultojne gati 800 ore pune
- Oret në total i pjestojmë me 8 orë pune ditore  $800 : 8 = 100$  kemi 100 punëtorë për një ditë pune
- Sipas grafikut te punimeve kemi gati 6 punonjes per 1muaj.

**2.3.8 Operatori ekonomik duhet te deklaroje ne formularin e vetdeklarimit se ka ne pronesi ose me qira mjetet e domosdoshme per realizimin e kontrates si me poshte :**

Mjetet	Sasia	Gjendja
1. Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes nga 7 ton deri 15 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
2. Kamioncine me kapacitet mbajtes sipas lejes se qarkullimit nga 1.5-3 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
3. Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
4. Autobitumatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
5. Rul me vibrim	1 copë	Pronësi ose me qera

( Shenim per kapacitetin mbajtes se mjeteve te kerkuara per realizimin e punimeve.Kapaciteti mbajtes i mjeteve sipas lejes se qarkullimit do llogaritet nga diferenca midis Mases maksimale me ngarkese te plote te lejuar ne Shqiperi dhe Mases se mjetit bosh.)

**“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :**

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:
1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
  2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
  3. Police sigurimi (e vlefshme)
  4. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme
  5. Certificate per leje transporti te leshuar nga Bashkia

dhe per mjetet me qera,

1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj.
2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
4. Police sigurimi (e vlefshme)
5. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme.]
6. Certificate per leje transporti te leshuar nga Bashkia

Ne rastin e mjeteve te marra me qera nga operatoret ekonomike bazuar ne njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit(leje qarkullimi,certifikate e transportit te mallrave ) ,mjetet nuk duhet te rezultojne per perdorim vetjak por per perdorim nga te tretet.

**b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten :**

per mjetet ne pronesi :

- aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

per mjetet me qera :

- të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj.
- aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

1- Autobitumatrice

Bazuar në zërin e preventivit për punime asfaltobetoni eshte kerkuar 1 autobitumatrice.

2- Kamioncinë 1 cope

eshte kerkuar 1 kamioncine për transportin e materialeve të ndryshme dhe të punonjësve.

3- Kamion vetshkarkues

Jane kerkuar 2 kamion vetshkarkues për transportin e materialeve të ndryshme

4-Asfaltoshtruese

Eshte kerkuar 1 Asfaltoshtruese bazuar ne preventive per punime asfalti.

5- Rul me vibrim

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.